



BASHKIA
TIRANË

URDHËR

Nr. 18194 / Datë 18.5 2017

“PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË APLIKIMIT DHE TË FORMATIT TË LICENCAVE, PËR TREGTIMIN ME PAKICË TË KARBURANTEVE, GAZIT TË LËNGSHËM TË NAFTËS, PËR AUTOMJETET, VAJRAVE LUBRIFIKANTË DHE LËNDËVE DJEGËSE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORËT FUNDORË, NË BASHKINË E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), nenit 21, pika 2, nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2016 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; vendimit nr. 970, datë 02.12.2015 të Këshillit Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kusheve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” (i ndryshuar),

URDHËROJ:

1. Miratimin e formularëve të aplikimit dhe të formatit të licencës për funksionimin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjete e vajra lubrifikantë, sipas *Aneksit Nr. 1, Aneksit Nr. 2 dhe Aneksit Nr. 3* bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Miratimin e formularëve të aplikimit dhe formatit të licencës për funksionimin e njësive të shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas *Aneksit Nr. 4, Aneksit Nr. 5 dhe Aneksit Nr. 6* bashkëlidhur këtij urdhri.
3. Urdhri nr.5098/1, datë 23.02.2016 i Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e formularëve të aplikimit dhe të formatit të licensave, të hartuar nga grupi i punës, i ngritur me Urdhrin e Kryetarit Nr. 4175, datë 09.02.2016 për “Ngritjen e grupit të punës për marrjen e masave dhe përcaktimit të procedurave që duhet të ndjek Bashkia e Tiranës për dhënien e licensave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, në Bashkinë e Tiranës” (i ndryshuar), shfuqizohet.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Erion VELIAJ

